

## STATISTIKAT E HOTELERISË, TM3 2018

### 1. Kontakti

1.1. Organizata Kontaktuese:	Agjencia e Statistikave të Kosovës - ASK
1.2. Njësia kontaktuese në organizatë:	Departamenti i Statistikave Ekonomike - Statistikat e Hotelërisë
1.3. Emri i kontaktit:	Violeta Sylja
1.4. Funkzioni i personit kontaktues:	Zyrtare për Statistika të Hoteleve
1.5. Adresa e plotë kontaktuese:	Rruga "Zenel Salihu" nr 4. 10000 Prishtinë, Kosovë
1.6. Adresa e emailit kontaktues:	violeta.sylja@rks-gov.net
1.7. Numri kontaktues:	+ 381 38 200 31 136
1.8. Numri kontaktues i faksit:	Nuk ka numër të faksit në dispozicion. Numri i faksit është i përgjithshëm: +381 38 235 033

### 2. Prezantimi i statistikave

2.1. Përshkrimi i të dhënave:	Objektivat kryesorë të statistikave të hotelërisë është sigurimi i të dhënave themelore të nevojshme lidhur me kapacitetin Hotelier në Kosovë, Shfrytëzimin e kapaciteteve Hoteliere të anketuara në Kosovë (%), numrin e vizitorëve vendor dhe të jashtëm, numrin e vizitorëve vendor sipas regjioneve, numrin e vizitorëve të jashtëm sipas vendeve prej nga vijnë si dhe numrin e netëqëndrimeve vendore dhe të jashtme.
2.2. Sistemi i klasifikimit:	Në hulumtim është përdorur Klasifikimi Evropian i Aktiviteteve Ekonomike (NACE Rev.2).
2.3. Mbulimi nga sektori:	Të dhënat e hotelërisë i mbulojnë sektorin economic.
2.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet:	Variablat kryesorë në publikimin e Hotelërisë janë: 1. Kapaciteti Hotelier paraqet numrin e hoteleve të anketuara, numrin e dhomave të tyre si dhe numrin e shtretërve në përgjithësi. 2. Numri i vizitorëve vendor sipas regjioneve është numri i personave me vendbanim të përhershëm në Kosovë, por të cilët qëndrojnë së paku një natë në një vend tjetër në Kosovë. 3. Numri i vizitorëve të jashtëm sipas vendeve prej nga vijnë, konsiderohet numri i personave me vendbanim të përhershëm jashtë Kosovës, por të cilët qëndrojnë përkohësisht në Kosovë për së paku një natë. 4. Numri i net qëndrimeve vendore dhe të jashtme -një vizitor(qoftë vendor apo i jashtëm) që kalon një natë brenda një objekti hotelier njihet si net qëndrim në hulumtimin tonë.
2.5. Njësia statistikore:	Burim i informacionit në sektorin e hotelërisë janë hotelet në të gjithë territorin e Kosovës.
2.6. Popullsia statistikore:	Korniza e mostrës së Hotelërisë përbëhet nga një listë e ndërmarrjeve aktive, të cilat në Regjistrin Statistikorë të Biznesit (SBR) janë të regjistruara në aktivitetin e Hotelërisë sipas kodit Nace Rev.2 . Përzgjedhja e Hoteleve për anketë është bërë sipas madhësisë së Hoteleve (CUT OFF) d.m.th. Hotelet të cilat kanë kapacitet më të lartë si dhe numër më të madhë të vizitorëve.
2.7. Zona referuese	Kosova (niveli kombëtar).

2.8. Mbulimi kohor:	Në vitin 2009 është bërë publikimi i parë në bazë vjetore i të dhënave hoteliere të grumbulluara për vitin 2008 dhe 2009. Ndërsa, nga viti 2010 të dhënat janë publikuar në bazë tremujore.
---------------------	---

2.9. Periudha bazë:	Nuk ka indeks të përdorur.
---------------------	----------------------------

### 3. Përpunimi statistikor

3.1. Burimi i të dhënave:	Informatat statistikore lidhur me aktivitetin e hotelierisë janë marrë nga hulumtimi statistikor i organizuar në tërë territorin e vendit nëpërmes zyrave rajonale statistikore, nëpërmjet anketës. Numri i hoteleve të vrojtuar rregullisht në bazë të mostrës është gjithsej 232, ndërsa madhësia e popullatës përfshinë afro 466 njësi hoteliere, te cilat nuk janë kryesisht hotele të mëdha por që në Regjistrin Statistikorë të Bizneseve janë të regjistruara në aktivitetin e Hotelierisë sipas kodit Nace Rev.2. Kategorizimi i hoteleve për anketë bëhet në bazë të madhësisë së tyre, kapaciteti më i lartë hotelier dhe numri i madhë i vizitorëve.
---------------------------	---

3.2. Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave:	Të dhënat e hotelierisë grumbullohen për periudha mujore nëpërmjet anketës në teren. Mbledhja e të dhënave zgjat përafërsisht 25 ditë.
---	--

3.3. Mbledhja e të dhënave:	Të dhënat janë mbledhur përmes emailit. Për të mbledhur të dhëna është përdorur Intervista personale e asistuar në letër.
-----------------------------	---

3.4. Vlefshmëria e të dhënave:	Kontrolli logjike është një procedurë e rregullt mbase arritjes së të dhënave nga tereni, para përfshirjes së tyre në program. Kjo bëhet nga ana e zyrtarit për statistika të hotelierisë nga zyra qendrore. Nëse haset në gabime eventuale të cilat janë lëshuar gjatë plotësimit së pyetësorit ato korrigjohen.
--------------------------------	---

3.5. Hartimi i të dhënave:	Në rastet kur kemi mungesë të të dhënave për ndonjë variabël të caktuar në pyetësorë ose nëse ndonjë hotel në kuadër të regjionit të caktuar për ndonjë arsye nuk ka raportuar fare në një tremujorë, atëherë bëhet imputimi i të dhënave (vlerësimi nga të dhënat e tremujorit te njëjtte të vitit paraprak).
----------------------------	--

3.6. Përshtatja/rregullimi:	Nuk është përdorur rregullim për statistikat e hoteleve.
-----------------------------	--

### 4. Menaxhimi i cilësisë

4.1. Sigurimi i cilësisë:	ASK është e angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në "LIGJIN Nr. 04/L-036 PËR STATISTIKAT ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS", ASK përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të saj, ASK ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). ASK ka zhvilluar një Deklaratë të Cilësisë e cila gjendet në faqen e internetit të ASK-së: <a href="http://ask.rks-gov.net/media/1889/deklarata-e-cilesise.pdf">http://ask.rks-gov.net/media/1889/deklarata-e-cilesise.pdf</a> . Dokumenti përmban njëmbëdhjetë parime, në përputhje me parimet e CoP, si pavarësia profesionale dhe konfidencialiteti statistikor, në të cilat bazohet puna e ASK-së.
---------------------------	--

4.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e hoteleve krahasohen me të dhënat e hoteleve në vitet e mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
<b>5. Relevanca</b>	
5.1. Nevojat e përdoruesve:	Qëllimi i publikimit është që të vejë në dukje tendencën e zhvillimit të këtij aktiviteti ekonomik në Kosovë. Ky publikim do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore të ASK-së, dhe si informacion i dobishëm dhe relevant ekonomik për Kosovën. Shfrytëzuesit kryesorë të të dhënave janë: Ministria e Industrisë dhe Tregtisë - Departamenti i Turizmit, për nevoja të jashtme, për qëllime hulumtimi (nga studentët, etj.) si dhe për nevoja të brendshme në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.
5.2. Kënaqshmëria e përdoruesve:	Njëra ndër elementet kyçe për të siguruar cilësinë e të dhënave statistikore është matja e kënaqshmërisë së përdoruesve. Anketa ka për qëllim që të grumbulloj informacion të plotë mbi nevojat dhe kërkesat e përdoruesve dhe shfrytëzuesve të të dhënave zyrtare statistikore. Me anë të kësaj ankete shfrytëzuesit e të dhënave statistikore kanë shprehur mendimet dhe opinionet e tyre lidhur me pikëpamjet statistikore, kanë dhënë këshilla dhe sugjerime lidhur me nevojat e tyre për statistika si dhe për përmirësimin e këtyre të dhënave statistikore në të ardhmen. Këtë vit u zhvillua për herë të dytë Anketa e kënaqshmërisë së përdoruesve. Qëllimi i këtij ankete është të matë nivelin e kënaqshmërisë së përdoruesve të të dhënave dhe të kemi informacion të plotë mbi nevojat dhe kërkesat e përdoruesve. Pyetësi u plotësua nga 34 përdorues, të përbërë nga 14 pyetje. Rezultatet e këtij studimi do të jenë në dispozicion në faqen e internetit të ASK-së.
5.3. Plotësia:	Nuk është në dispozicion.
5.4. Plotësia - norma, shkalla:	Nuk është në dispozicion.
<b>6. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
6.1. Saktësia e përgjithshme:	Si kornizë për krijimin e mostrës së hotelerisë është përdorur Regjistri i kapaciteteve hoteliere në Kosovë i realizuar në vitin 2016. Ndërsa rezultatet bazohen në një mostër të hoteleve, ato i nënshtrohen llojeve të zakonshme të gabimeve që lidhen me teknikat e nxjerrjes së mostrave dhe intervistave, siç janë gabimet e nxjerrjes së mostrave, gabimet gjatë fazës së intervistimit, gabimet e matjes, gabimet e përpunimit dhe mosgjigjet. Gabimet e mostrimit shoqërohen nga devijime statistikore.
6.2. Gabimi në mostra:	Efekti i rastësishëm për shkak të mostrimit do të thotë se rezultatet e llogaritura nga mostra të ndryshme devijojnë disi nga njëri-tjetri. Pasaktësia për shkak të dizajnit dhe përzgjedhjes së mostrës vlerësohet me gabimin standard të vlerësimit. Madhësia e gabimit standard ndikohet nga madhësia e mostrës dhe varianca e variablave që janë objekt studimi. Gabimi standard mund të përdoret për të llogaritur intervalin e besimit, brenda të cilit vlera e popullsisë qëndron me një probabilitet të caktuar.
6.2.1. Gabimi në mostra - treguesit:	Nëse mostra është mjaft e madhe dhe e zgjedhur në mënyrë shkencore, pasiguria e vlerësimeve në përgjithësi do të jetë e vogël.

6.3. Gabim jo - i mostrave:	Gabimet e mos marrjes së mostrave janë gabimi që kanë ndodhur gjatë fazave të tjera të anketës: Gabimi i mbulimit janë gabimet që lidhen me kornizën; divergjencat midis kornizës dhe popullatës së synuar. Gabimet që ndodhin gjatë grumbullimit të të dhënave, gabimet e përpunimit dhe gabimi i mos përgjigjes kur anketa nuk arrin të marrë përgjigje ndaj një ose ndoshta të gjitha pyetjeve.
6.3.1. Mbulimi i gabimit:	Gabimet e mbulimit përfshijnë si mbi-mbulimin ashtu edhe nën-mbulimin. Nëse përditësimi i fundit nga Regjistri i kapaciteteve hoteliere në Kosovë nga viti 2016 nuk janë të përfaqësuar mirë për shkak të ndryshimeve në terren atehere gabimet e mbulueshmerisë lindin për shkak të dallimeve ndërmjet kornizës dhe hoteleve të synuara. Gabimi i nën-mbulimit është që hoteleve të synuara nuk janë të qasshme nëpërmjet kornizës dhe ato gabime janë të vështira për t'u matur. Gabimi i mbi-mbulimit është gabimi për shkak të qasshmërisë së njësisë nëpërmjet kornizës që nuk i përkasin popullsisë së synuar. Fokusi kryesor ishte gabimi i mbi-mbulimit.
6.3.1.1. Mbi - mbulimi - norma, shkalla:	Mbi mbulimi përbëhet nga hotelet që nuk janë aktive, etj. Shkalla e mbimbulueshmerisë është 0.8 %.
6.3.1.2. Njësitë e përbashkëta - proporcioni:	Nuk është e zbatueshme.
6.3.2. Gabimi në matje:	Të dhënat mbledhen nëpërmjet Intervistës Personale të Ndihtuar me Letër (PAPI) të mbikqyrur nga zyrat rajonale. Intervista është bërë nga stafi profesional-punonjës i përhershëm; Trajnimi adekuat i intervistuesve - për të shmangur refuzimin dhe gabimet; Kontrollimi në terren lidhur me cilësinë. Ri-kontaktimi i hoteleve pas intervistimit.
6.3.3. Gabimi në mos - përgjigje:	Gabimet e mos përgjigjes janë gabimet kur anketa nuk arrin të marrë përgjigje ndaj një ose ndoshta të gjitha pyetjeve.
6.3.3.1. Njësia jo - përgjigje - norma P:	Shkalla e mos përgjigjes është 12.19%. Prej tyre 11.2% janë refuzime.
6.3.3.2. Artikulli jo - përgjigje - norma P:	Not available.
6.3.4. Gabimi në përpunim:	Gabimet gjatë përpunimit të të dhënave janë për shkak të gabimeve teknike.
6.3.4.1. Norma e Imputimit:	Nuk është në dispozicion.
6.3.5. Gabimi në supozim të modelit:	Nuk është në dispozicion.
6.4. Rregullimi sezonal:	Nuk është në dispozicion.
6.5. Rishikimi i të dhënave - politika:	Në ASK nuk ka politika të rishikimit.
6.6. Rishikimi i të dhënave - praktika:	Nuk është kryer asnjë rishikim.
6.6.1. Rishikimi i të dhënave - madhësia mesatare:	Nuk është në dispozicion.
<b>7. Afati kohor dhe përpikëria</b>	
7.1. Afati kohor:	Nga viti 2010 të dhënat janë publikuar në baza tremujore.
7.1.1. Vonesa në kohë - rezultatet e para:	Nuk është në dispozicion.

7.1.2. Vonesa në kohë - rezultatet përfundimtare për P:	Rezultatet përfundimtare janë publikuar me 7 mars 2018.
7.2. Përpikëria:	Te dhënat e hotelerisë janë publikuar në kohë.
7.2.1. Përpikëria - ofrimi dhe përpunimi për P:	Vonesa në kohë është 0.
<b>8. Koherenca dhe krahasueshmëria</b>	
8.1. Krahasueshmëria - gjeografike:	Statistikat i referohen nivelit kombëtar.
8.1.1. Asimetria për pasqyrën e rrjedhës së statistikave - koeficienti:	Nuk është në dispozicion.
8.2. Krahasueshmëria nëpër kohë:	Ne vitin 2009 te dhenat jane publikuar ne baze vjetore, ndërsa nga viti 2010 kane filluar te publikohen ne baza tremujore.
8.2.1. Gjatësia e serive kohore të krahasueshme për P:	Krahasueshmëria është nga 2010-2018. CC2 =9.
8.3. Koherenca - fushat e ndërlidhura:	Nuk është në dispozicion.
8.4. Koherenca - statistikat gjysmë-vjetore dhe vjetore:	Nuk është në dispozicion.
8.5. Koherenca - Llogaritë Kombëtare:	Nuk është në dispozicion.
8.6. Koherenca - e brendshme:	Të dhënat kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre. Të dhënat janë koherente në aspektin e brendshëm.
<b>9. Qasja dhe qartësia</b>	
9.1. Njoftimet për shtyp:	Njoftimet për shtyp janë on-line në kohën e shpërndarjes së të dhënave. Përshkrimi shkurtër në dokumentacionin e metodologjisë përfshin numrin e të punësuarve, numrin e pronarëve që punojnë, qarkullimin e ndërmarrjeve dhe atë për mallrat e prodhuara nga ndërmarrja, mallrat nga tregtia dhe shërbimet, nën-kontraktuesit si dhe të ardhurat tjera, blerjet që ndërmarrja ka realizuar për zhvillimin e aktivitetit ekonomik etj.
9.2. Publikimet:	Publikimet e ASK-së, tabelat dhe materialet për njoftim për shtyp, janë gjithmonë në dispozicion në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht.
9.3. Baza e të dhënave online:	ASK ka bazën e të dhënave online: <a href="http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/?rxid=48d7fed2-90d9-4873-8854-c1e793ecafad">http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/?rxid=48d7fed2-90d9-4873-8854-c1e793ecafad</a>
9.3.1. Tabelat e të dhënave - konsultimet:	Nuk është në dispozicion.
9.4. Qasja në mikro - të dhënat:	Përdoruesit nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë në mikro-të dhënat, por me ligj studiuesit/hulumtuesit dhe institucionet mund të kërkojnë qasje përmes ASK-së.
9.5. Tjetër:	Nuk është në dispozicion.
9.6. Dokumentacioni mbi metodologjinë:	Metodologjia për hotele është përshkruar në publikim në pjesën e metodologjisë së anketimit: <a href="http://ask.rks-gov.net/media/4451/hoteleria-tm3-2018-shqip.pdf">http://ask.rks-gov.net/media/4451/hoteleria-tm3-2018-shqip.pdf</a>
9.7. Dokumentacioni për cilësi:	Asnjë vlerësim për cilësinë nuk është në dispozicion.
9.7.1. Shkalla e plotësisë - metadata:	Nuk është në dispozicion.
9.7.2. Metadata - konsultime:	Nuk është në dispozicion.

## 10. Kostoja dhe barra

Në Statistikat e hoteleve janë duke punuar dy persona për të gjitha fazat si redaktimi, përpunimi, analizimi dhe publikimi i të dhënave.

## 11. Konfidencialiteti

### 11.1. Konfidencialiteti - politika:

"Agjencia do të sigurojë që të dhënat individuale të mbledhura për qëllime statistikore, të mbledhura nga persona fizikë ose juridikë, apo organet dhe organizatat e administratës publike (më tej "Respodentët"), të trajtohen në mënyrë rreptësishtë konfidenciale dhe të përdoren vetëm për qëllime statistikore. Ligji 04/L-036, Neni 34.

"Të gjithë të anketuarit (respodentët) janë të detyruar, në pajtim me ligjin në fuqi, të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë të dhëna në kohë dhe me saktësi statistikore në Agjenci, dhe të bashkëpunojnë me Agjencinë për të verifikuar saktësinë e të dhënave të mbledhura. LIGJI Nr. 04/L-036 PËR STATISTIKAT ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Neni 21: <http://ask.rks-gov.net/media/2023/ligji-per-statistikat-zyrtare-te-republikes-se-kosoves.pdf>

### 11.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave:

Qasja në të dhënat konfidenciale do t'u lejohet vetëm personave të cilët janë përgjegjës për prodhimin e statistikave zyrtare deri në atë nivel që këto të dhëna janë të nevojshme për prodhimin e statistikave. Neni 37, Ligji Nr 04/L-036: <http://ask.rks-gov.net/media/2023/ligji-per-statistikat-zyrtare-te-republikes-se-kosoves.pdf>

## 12. Komentë